



Thinking of you
Electrolux



EOB6850

.....
SQ FURRË

.....
UDHËZIMET PËR
PËRDORIM

2

HU SÛTŐ

HASZNÁLATI ÚTMUTATÓ

41



PËRMBAJTJA

1. TË DHËNA PËR SIGURINË	3
2. PËRSHKRIM I PRODUKTIT	5
3. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË	5
4. PANELI I KONTROLLIT	6
5. PËRDORIMI I PËRDITSHËM	8
6. FUNKSIONET E ORËS	12
7. PROGRAMET AUTOMATIKE	14
8. PËRDORIMI I AKSESORËVE	14
9. FUNKSIONET SHITESË	17
10. UDHËZIME DHE KËSHILLA TË NEVOJSHME	18
11. KUJDESI DHE PASTRIMI	32
12. SI TË VEPROJMË NËSE...	37
13. TË DHËNA TEKNIKE	39
14. INSTALIMI	39
15. PROBLEME QË LIDHEN ME MJEDISIN	40

ME JU NË MENDJE

Faleminderit që bletë një produkt Electrolux. Ju keni zgjedhur një produkt i cili sjell me vete dekada të tëra me përvojë dhe risi nga profesionistë. Gjenial dhe elegant, ky produkt është projektuar duke ju pasur ju në mendje. Pra, sa herë që ta përdorni mund të ndjeheni të sigurt se çdo herë do të merrni prej tij rezultate të shkëlqyera.

Mirë se vini në Electrolux.

Vizitoni faqen tonë të internetit në adresën:



Merrni këshilla përdorimi, broshura, informacion për ndreqjen e problemeve si dhe për shërbimin:

www.electrolux.com



Regjistroni produktin tuaj për shërbim më të mirë:

www.electrolux.com/productregistration



Blini aksesore, pjesë konsumi, pjesë këmbimi origjinale për pajisjen tuaj:

www.electrolux.com/shop

KUJDESI DHE SHËRBIMI PËR KLIENTËT

Rekomandojmë përdorimin e pjesëve origjinale të këmbimit.

Kur kontaktoni me Shërbimin, sigurohuni që të dispononi të dhënat e mëposhtme.

Informacioni mund të gjendet në pllakën e specifikimeve. Modeli, PNC, Numri i serisë.



Paralajmërim / Të dhëna për sigurinë dhe kujdesin.



Të dhëna të përgjithshme dhe këshilla



Të dhëna për ambientin

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

1. TË DHËNA PËR SIGURINË

Përpara instalimit dhe përdorimit të pajisjes, lexoni me kujdes udhëzimet e ofruara. Prodhuesi nuk është përgjegjës nëse shkaktohen lëndime dhe dëme nga instalimi dhe përdorimi i pasaktë. Gjithmonë mbajini udhëzimet bashkë me pajisjen, për t'iu referuar në të ardhmen.

1.1 Siguria e fëmijëve dhe personave me probleme



PARALAJMËRIM

Rrezik mbytjeje, lëndimi ose gjymtimi të përhershëm.

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e sipër dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijmësh ose mendore ose që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, nëse këta mbahen nën mbikëqyrje ose udhëzohen për përdorimin e pajisjes nga një person që është përgjegjës për sigurinë e tyre.
- Mos lejoni fëmijët të luajnë me pajisjen.
- Mbajini të gjitha materialet e ambalazhimit larg fëmijëve.
- Mbajini fëmijët dhe kafshët shtëpiake larg pajisjes gjatë kohës që ajo është në punë ose kur ftohet. Pjesët e prekshme janë të nxehta.
- Nëse pajisja ka një mekanizëm për sigurinë e fëmijëve, ju rekomandojmë që ta aktivizoni.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja nuk duhet të kryhet nga fëmijët pa mbikëqyrje.

1.2 Instalimi



PARALAJMËRIM

Vetëm një person i kualifikuar duhet ta instalojë këtë pajisje.

- Hiqni të gjithë paketimin.
- Mos instaloni ose mos përdorni një pajisjen të dëmtuar.
- Zbatoni udhëzimet e instalimit të dhëna me pajisjen.
- Gjithmonë bëni kujdes kur e lëvizni pajisjen sepse është e rëndë. Përdorni gjithnjë doreza sigurie.
- Mos e tërhiqni pajisjen nga doreza.

- Ruani largësitë minimale nga pajisjet dhe njësitë e tjera.
- Sigurohuni që pajisja të jetë e instaluar nën dhe pranë strukturave të sigurta.
- Anët e pajisjes duhet të jenë pranë pajisjeve ose njërive me të njëjtën lartësi.

Lidhja elektrike



PARALAJMËRIM

Rrezik zjarri dhe goditjeje elektrike.

- Të gjitha lidhjet elektrike duhen kryer nga një elektrikist i kualifikuar.
- Pajisja duhet tokëzuar.
- Sigurohuni që të dhënat elektrike në pllakën e specifikimeve të përkohë me karakteristikat e rrjetit elektrik. Nëse nuk përkohë, kontaktoni me një elektrikist.
- Përdorni gjithmonë një prizë të tokëzuar të instaluar si duhet.
- Mos përdorni përshtatës me shumë spina dhe kablo zgjatuese.
- Sigurohuni që të mos dëmtoni prizën dhe kabllon elektrike. Kontaktoni me qendrën e shërbimit ose një elektrikist për ndërrimin e kabllot elektrike të dëmtuar.
- Mos i lini kabllot që të prekin derën e pajisjes, veçanërisht kur dera është e nxehtë.
- Mbrojtja nga goditja e pjesëve me korrent dhe të izoluar duhet të shtrëngohet në mënyrë të tillë që të mos hiqet pa vegla.
- Pajisjen futeni në prizë vetëm në fund të instalimit. Sigurohuni që spina të jetë e arritshme pas montimit të pajisjes.
- Nëse priza është e lirë, mos e futni spinën.
- Mos e shkëputni pajisjen nga rrjeti duke e tërhequr nga kabloja elektrike. Gjithmonë tërhiqeni kabllon duke e kapur nga spina.
- Përdorni mjetet e duhura izoluese: çelësa mbrojtës të linjës, siguresa (siguresa tip vidë të hequra nga mbajtësja), çelësa të humbjeve në tokëzim dhe kontaktorë.

- Instalimi elektrik duhet të ketë një pajisje instaluese e cila ju lejon të shkëpusni pajisjen nga rryma elektrike në të gjitha polet. Pajisja instaluese duhet të ketë një hapje kontakti me gjerësi minimale 3 mm.

1.3 Përdorimi



PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi, djegiesh ose goditjeje elektrike ose shpërthimi.

- Përdoreni pajisjen në mjedis shtëpiak.
- Mos i ndryshoni specifikimet e kësaj pajisjeje.
- Sigurohuni që vrimat e ajrimit nuk janë të blokuara.
- Mos e lini pajisjen të pambikëqyrrur gjatë punës.
- Çaktivizojeni pajisjen pas çdo përdorimi.
- Kur përdoret, pajisja nxehet nga brenda. Mos i prekni elementet e nxehtës që gjenden në pajisje. Përdorni gjithmonë doreza furre për të hequr ose për të futur aksesor ose enë për furrë.
- Bëni kujdes kur hapni derën e pajisjes ndërkohë që pajisja është në punë. Mund të dal ajër i nxehtë.
- Mos e përdorni pajisjen me duar të lagura ose kur ajo ka kontakt me ujin.
- Mos ushtroni presion mbi derën e hapur.
- Mos e përdorni pajisjen si sipërfaqe pune ose për të ruajtur sende.
- Mbajeni gjithmonë të mbyllur derën e pajisjes kur pajisja është në punë.
- Hapeni me kujdes derën e pajisjes. Përdorimi i përbërësve me alkoool mund të krijoj një përzjerje alkoooli dhe ajri.
- Mos lejoni që pajisja të bjer në kontakt me shkëndija apo flakë të hapura kur hapni derën.
- Mos vendosni produkte të ndezshme ose sende të lagura me produkte të ndezshme brenda, pranë ose mbi pajisjeje.



PARALAJMËRIM

Rrezik dëmtimi i pajisjes.

- Për të parandaluar dëmtime ose çngjyrimet e smaltit:
 - Mos vendosni enë furre ose objekte të tjera drejtpërdrejt në fund të pajisjes.

- Mos fusni letër alumini direkt në pjesën e poshtme të pajisjes.
- mos hidhni ujë drejtpërdrejt në pajisjen e nxehtë.
- mos lini enë të lagura dhe ushqim në pajisje pasi të keni mbaruar gatimin.
- bëni kujdes kur hiqni ose vendosni aksesoret.

- Çngjyrimi i smaltit nuk ndikon në funksionimin e pajisjes. Ai nuk konsiderohet defekt në kuptimin e ligjit për garancinë.
- Përdorni një tigan të thellë për kek të njomë. Lëngjet e frutave shkaktojnë njolla që mund të jenë të përhershme.

Gatimi me avull



PARALAJMËRIM

Mund të digjeni dhe të dëmtoni pajisjen.

- Mos e hapni derën e pajisjes gjatë gatimit me avull. Mund të çlirohet avull.

1.4 Kujdesi dhe pastrimi



PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi, zjarri ose dëmtimi të pajisjes.

- Përpara se të kryeni mirëmbajtjen e pajisjes, çaktivizojeni atë dhe hiqeni nga priza.
- Sigurohuni që pajisja të jetë e ftohtë. Ka rrezik që panelet e xhamit të thyhen.
- Ndërrojini menjëherë panelet prej xhami të derës kur janë të dëmtuara. Lidhuni me Servisin.
- Tregoni kujdes kur ta hiqni derën nga pajisja. Dera është e rëndë!
- Pastrojini pajisjen rregullisht për të parandaluar dëmtimin e materialit të sipërfaqes.
- Yndyra ose ushqimi i mbetur brenda pajisjes mund të shkaktojë zjarr.
- Pastrojini pajisjen me një leckë të butë të lagësht. Përdorni vetëm detergjente neutrale. Mos përdorni produkte gërryese, materiale pastruese të ashpra, tretës ose objekte metalike.
- Nëse përdorni spërkatës për furrën, ndiqni udhëzimet e sigurisë në paketim.

- Mos e pastroni smaltin katalitik (nëse ka) me asnjë lloj detergjenti.

1.5 Drita e brendshme

- Lloji i llambës ose llambës halogjene të përdorur për këtë pajisje, është vetëm për pajisje elektroshtëpiake. Mos e përdorni atë për ndriçim banese.



PARALAJMËRIM

Rrezik nga goditja elektrike.

- Përpara ndërrimit të llambës, shkëputeni pajisjen nga korrenti.
- Përdorni vetëm llamba me të njëjtat specifikime.

1.6 Eliminimi i pajisjes




PARALAJMËRIM

Rrezik lëndimi ose mbytjeje.

- Shkëputeni pajisjen nga rrjeti i furnizimit elektrik.
- Prisi kabllon e lidhjes me rrjetin dhe hidheni.
- Hiqni kapësen e derës për të parandaluar bllokimin brenda pajisjes të fëmijëve dhe të kafshëve shtëpiake.

2. PËRSHKRIM I PRODUKTIT



- 1 Programuesi elektronik
- 2 Sirtari i ujit
- 3 Skarë
- 4 Llamba e furrës
- 5 Ventilatori
- 6 Mbështetëset e rafteve, të çmontueshme

- 7 Tubi i shkarkimit
- 8 Valvula e shkarkimit të ujit
- 9 Etiketa e specifikimeve
- 10 Pozicionet e raftit
- 11 Hyrja e avullit

2.1 Aksesorët e furrës

• Rafti me rrjetë

Për enët e gatimit, tavat e kekëve dhe të pjekjes.

• Tavë për pjekje

Për ëmbëlsira dhe biskota.

• Tava e skarës/pjekjes

Për të pjekur ose si tavë për të mblledhur yndyrën.

• Shinat teleskopike

Për rafte dhe tava.

• Tava dietike

Për funksionet e gatimit me avull.

3. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË



PARALAJMËRIM

Referojuni kapitullit "Të dhëna për sigurinë"

3.1 Pastrimi paraprak

- Hiqni të gjithë aksesoret dhe mbështetëset e rafteve që mund të hiqen (nëse ka).
- Pastroni pajisjen përpara përdorimit të parë.



Referojuni kapitullit "Kujdesi dhe pastrimi".

3.2 Lidhja për herë të parë



Kur lidhni pajisjen për herë të parë me korrentin ose pas një ndërprerjeje të energjisë që mund të keni pasur, ju duhet të vendosni gjuhën, kontrastin e ekranit, ndriçimin e ekranit dhe kohën ditore.

1. Prekni  ose  për të vendosur vlerën.

2. Prekni **OK** për të konfirmuar.

3.3 Parangrohja


Ngrohni paraprakisht pajisjen bosh për të djegur yndyrën e mbetur.

1. Vendosni funksionin  dhe temperaturën maksimale.
2. Lëreni pajisjen të punojë për 45 minuta.
3. Vendosni funksionin  dhe temperaturën maksimale.
4. Lëreni pajisjen të punojë për 15 minuta.




Aksesoret mund të nxehen më shumë sesa zakonisht. Pajisja mund të nxjerrë erë të keqe dhe tym. Kjo është normale. Sigurohuni që të ketë ajrosje të mjaftueshme.







4. PANELI I KONTROLLIT


Programuesi elektronik



Përdorni fushat me sensor për të vënë në funksionim pajisjen








Numri	Fusha e sensorit	Funksioni	Koment
1		Ndezja/Fikja	Për të aktivizuar dhe çaktivizuar pajisjen.
2		Funksionet e nxehjes ose Gatim i asistuar	Për të zgjedhur një funksion nxehjeje ose një funksion Gatim i asistuar . Për të vajtur te funksioni i duhur, prekni fushën një ose dy herë kur pajisja është e aktivizuar. Për të aktivizuar ose çaktivizuar dritën, prekni fushën për 3 sekonda. Ju mund ta aktivizoni dritën edhe kur pajisja është e çaktivizuar.
3		Butoni kryesor	Për t'u kthyer një nivel në meny. Për të treguar menyën kryesore, prekni fushën për 3 sekonda.

Numri	Fusha e sensorit	Funksioni	Koment
4		Zgjedhja e temperaturës	Për të vendosur temperaturën ose për të treguar temperaturën aktuale në pajisje. Për të aktivizuar ose çaktivizuar funksionin Nxehje e shpejtë , prekni fushën për 3 sekonda.
5		Programi i preferuar	Për të ruajtur dhe për të shkuar te programi juaj i preferuar.
6		Butoni lart	Për të lëvizur lart në meny.
7		Butoni poshtë	Për të lëvizur poshtë në meny.
8		Koha dhe funksionet shtesë	Për të vendosur funksione të ndryshme. Kur një funksion nxehjeje është në punë, prekni fushën e sensorit për të vendosur kohëmatësin, Sigurinë për fëmijët memorien e Programi i preferuar , Nxeh + Mbaj , Cilëso + Nis , ose për të ndryshuar cilësimet e sensorit të temperaturës (vetëm për disa modele).
9		Kujtuesi i minutave	Për të vendosur Kujtuesi i minutave .
10	OK	OK	Për të konfirmuar përzgjedhjen ose cilësimin.
11	—	Ekрани	Tregon vendosjet aktuale të pajisjes.

Ekрани

- A)** Funksioni i nxehjes
- B)** Ora e ditës
- C)** Treguesi i nxehjes
- D)** Temperatura
- E)** Funksionet Kohëzgjatja dhe Koha përfund.

Tregues të tjerë në ekran

Simboli	Funksioni
	Kujtuesi i minutave Funksioni vihet në punë.
	Ora e ditës Ekрани tregon orën e ditës.
	Kohëzgjatja Ekрани tregon kohën e nevojshme të gatimit.
	Koha përfund. Ekрани tregon kur përfundon koha e gatimit.
	Treguesi i orës Ekрани tregon për sa kohë punon funksioni i nxehjes. Shtypni  dhe  njëkohësisht për ta kthyer orën në zero.

Simboli		Funksioni
	Treguesi i nxejjes	Ekрани tregon temperaturën në pajisje.
	Treguesi Nxejje e shpejtë	Funksioni vihet në punë. Ky funksion ul kohën e nxejjes.
	Peshë automatike	Ekрани tregon se është në punë sistemi i peshës automatike ose se mund të ndryshoni peshën.
	Nxeh + Mbaj	Funksioni vihet në punë.

5. PËRDORIMI I PËRDITSHËM



PARALAJMËRIM

Referojuni kapitullit "Të dhëna për sigurinë"

- Shtypni ∇ ose \blacktriangle për të përzgjedhur opsionin e menysë.
- Shtypni **OK** për të shkuar tek nënmenyja ose për të pranuar cilësimin.

Në çdo pikë ju mund të ktheheni te menyja kryesore me \leftarrow

5.1 Navigimi mes menyve

Funksionimi i menyve:

- Aktivizoni pajisjen.

5.2 Përshkrim i menyve

Menyja kryesore

Simboli	Zëri i menysë	Përdorimi
	Speciale	Përmban një listë shtesë të funksioneve të nxejjes.
	Funksionet e nxejjes	Përmban një listë të funksioneve të nxejjes.
	Gatim i asistuar	Përmban një listë të funksioneve automatike të gatimit.
	Programi i preferuar	Përmban një listën të programeve të gatimeve të preferuara, të ruajtura nga përdoruesi.
	Cilësimet bazë	Përmban një listë të cilësimeve të tjera.







Nënmenytë për: Cilësimet bazë







Simboli	Nënmenyja	Përshkrimi
	Cilëso orën e ditës	Cilëson orën aktuale në ekran.
	Treguesi i orës	Kur është NDEZUR, ekрани tregon kohën aktuale kur çaktivizoni pajisjen.
	CILËSO + NIS	Kur është NDEZUR, ju mund të aktivizoni funksionet kur aktivizoni funksionin e nxejjes.

Simboli	Nënmenyja	Përshkrimi
	Nxeh + Mbaj	Kur është NDEZUR, ju mund të aktivizoni këtë funksion kur aktivizoni një funksion nxehjeje.
	Kohë shtesë	Aktivizon dhe çaktivizon funksionin.
	Kontrasti i ekranit	Rregullon kontrastin e ekranit me gradë.
	Drita e ekranit	Rregullon dritën e ekranit me gradë.
	Cilëso gjuhën	Vendos gjuhën e ekranit.
	Volumi i ziles	Rregullon volumin e toneve të shtypjes dhe sinjaleve me gradë.
	Tingujt e butonave	Aktivizon dhe çaktivizon tonin e fushave me prekje.
	Tinguj Alarmi/Defekti	Aktivizon dhe çaktivizon tonet e alarmit.
	Servisi	Tregon versionin dhe konfigurimin e softuerit.
	Cilësimet e fabrikës	Rivendos të gjitha cilësimet në cilësimet e fabrikës.









5.3 Funksionet e nxehjes

Nënmenyja për: Funksionet e nxehjes

Funksioni i nxehjes	Përdorimi
 Ventilator i plotë	Për të pjekur në një maksimum prej tre nivele raftesh njëkohësisht. Kur e përdorni këtë funksion, uleni temperaturën e furrës me 20 - 40°C nga temperaturat standarde që përdorni për Gatim tradicional .
 Ventilator i plotë + Avull	Për gatesa me avull. Përdorni këtë funksion për të rritur kohën e gatimit dhe për të ruajtur vitaminat dhe lëndët ushqyese në ushqim. Për ta përdorur, zgjidhni funksionin dhe vendoseni temperaturën nga 130 °C deri në 230 °C.
 Cilësimi për pica	Për të gatuar pica, quiche ose kek me avull.
 Gatim tradicional	Për të pjekur në një nivel.
 Gatim i ngadaltë	Për përgatitjen veçanërisht të mishit të njomë dhe me lëng.
 Nxehtësia e poshtme	Për pjekjen e kekëve me bazë krokante ose të thekur, si dhe për ruajtjen e ushqimit.

Funksioni i nxehtjes	Përdorimi
 Pjekje EKO	Funksionet EKO ju lejojnë të përdorni me efikasitet energjinë gjatë gatimit. Është e nevojshme që ta vendosni kohën e gatimit në fillim.
 Ushqime të ngrira	Për të gatuar ushqime të shpejta si p.sh. patate të skuqura, feta ose kuleç krokantë.
 Pjekja në skarë	Për të pjekur në qendër të skarës ushqime të sheshta dhe për të thekur bukë.
 Skarë e shpejtë	Për të pjekur në skarë ushqime të sheshta në sasi të mëdha dhe për të thekur bukë.
 Skarë turbo	Për të pjekur copa mishi më të mëdha ose shpezë me kocka në një pozicion rafti. Gjithashtu për të skuqur dhe karamelizuar.
 Krijim avulli	Për të ngrohur sërish ushqimin e gatuar direkt në një pjatë.

Nënmenyja për: **Speciale**

Funksioni i nxehtjes	Përdorimi
 Pjekja e bukës	Për të pjekur bukë me avull.
 Au Gratin	Për të përgatitur ushqime të tilla si lasanja ose patate gratin. Gjithashtu për të skuqur dhe karamelizuar.
 Ardhja e brumit	Që të vijë brumi me maja përpara pjekjes.
 Ngrohja e pjatave	Për të ngrohur më parë një pjatë që do të shërbehet.
 Konservimi	Për të ruajtur zarzavate (p.sh. turshi të përziera) në kavanoza dhe lëng.
 Tharja	Për të tharë fruta me feta si mollë, kumbulla, pjeshkë dhe zarzavate si domatet, kungulleshkat ose kërpudhat.
 Mbaj ngrohtë	Për ta mbajtur të ngrohtë ushqimin e gatuar.
 Shkrirja	Për të shkrirë ushqime të ngrira.


5.4 Aktivizimi i një funksioni nxehtjes

1. Aktivizoni pajisjen.

2. Përzgjidhni menynë Funksionet e nxehtjes . Shtypni **OK** për të konfirmuar.

3. Cilësoni funksionin e nxehtjes. Shtypni **OK** për të konfirmuar.

4. Vendosni temperaturën. Shtypni **OK** për të konfirmuar.

i Shtypni një herë ose dy herë  për të shkuar direkt te menyja Funksionet e nxehtësë (kur pajisja është e aktivizuar).

5.5 Gatimi me avull

i Mbulesa e sirtarit të ujit është tek paneli i kontrollit.

1. Shtypni mbulesën për të hapur sirtarin e ujit.
2. Mbushni sirtarin e ujit me 900 ml ujë. Kjo sasi uji mjafton për rreth 55 - 60 minuta.



Mos hidhni ujë drejtpërdrejt te krijuesi i avullit. Përdorni vetëm ujë. Mos përdorni ujë të filtruar (të çmineralizuar) ose të distiluar. Mos përdorni lëngje të tjera. Mos vendosni lëngje të djegshme ose alkoolike në sirtarin e ujit.

3. Vendoseni sirtarin e ujit në pozicionin e tij fillestar.
4. Aktivizoni pajisjen.
5. Përgatisni ushqimin në enët e duhura.
6. Regjistroni funksionin e gatimit me avull dhe temperaturën.
7. Nëse është e nevojshme, vendosni funksionin Kohëzgjatja $\left| \rightarrow \right|$ ose Koha përfund. $\rightarrow \left| \right|$
Sinjali bie në përfundim të kohës së gatimit.
8. Çaktivizoni pajisjen. Lëreni pajisjen të thahet plotësisht me derën hapur.
9. Zbrazni sirtarin e ujit pasi përfundon gatimi me avull.



PARALAJMËRIM

Prisni të paktën 60 minuta pas çdo përdorimi të gatimit me avull, për të shmangur daljen e ujit të nxehtë nga valvula e daljes së ujit.

5.6 Treguesi i rezervuarit të zbrazur

Ekrani tregon Kërkohej ujë dhe bie një sinjal akustik kur rezervuari i ujit është bosh dhe duhet rimbushur. Për më shumë informacion referojuni "Gatimi me avull".

5.7 Treguesi i rezervuarit plot

Kur ekrani tregon Rezervuari i ujit plot, mund të zgjidhni gatimin me avull. Një sinjal akustik bie kur rezervuari është fikur.



Nëse hidhni shumë ujë në rezervuar, valvula e sigurisë e derdh ujin e tepërt në fund të furrës.


Fshijeni ujin me një sfungjer apo me një leckë.

5.8 Boshatisja e depozitës së ujit



Sigurohuni që pajisja të jetë ftohur përpara se të filloni të zbrazni rezervuarin e ujit.

1. Përgatitni tubin e shkarkimit (C), të përfshirë në të njëjtën paketë me manualin e përdorimit. Vendoseni konektorin (B) në njërin fund të tubit të shkarkimit.



2. Vendoseni fundin tjetër të tubit shkarkues (C) në një enë. Vendoseni në një pozicion më të ulët se valvula e daljes (A).
3. Hapni derën e furrës dhe futeni konektorin (B) në valvulën e daljes (A).

4. Shtyjeni vazhdimisht konektorin kur zbrazeni rezervuarin.
5. Hiqni konektorin nga valvula kur uji ndalon së rrjedhuri.



PARALAJMËRIM

Mos e përdorni ujin e shkarkuar për të rimbushur rezervuarin e ujit.




Rezervuari mund të ketë ujë kur ekrani tregon Kërkohet ujë . Prisi derisa sa të ndalojë rrjedhja e ujit nga valvula e shkarkimit të ujit.

5.9 Treguesi i nxehtjes

Kur aktivizoni një funksion të nxehtjes, ekrani shfaq vijën. Vija tregon se temperatura po ngrihet.

5.10 Treguesi Nxehtje e shpejtë

Ky funksion ul kohën e nxehtjes. Për ta aktivizuar këtë funksion mbani shtypur  për 3 sekonda. Do të shihni se treguesi i nxehtjes ndryshon.


5.11 Ngrohtësia e mbetur

Kur e çaktivizoni pajisjen, ekrani tregon ngrohjen e mbetur. Ju mund ta përdorni këtë nxehtësi për të mbajtur ushqimin e ngrohtë.

5.12 Kursimi i energjisë









Pajisja ka karakteristika që ju ndihmojnë të kurseni energji gjatë gatimit të përditshëm:

- **Ngrohtësia e mbetur:**
 - Kur funksioni ose programi i ngrohjes është në punë, elementët e ngrohjes çaktivizohen 10 % më parë (llamba dhe ventilatori vazhdojnë të funksionojnë). Që kjo karakteristikë të funksionoj, koha e gatimit duhet të jetë më e gjatë se 30 minuta ose ju duhet të përdorni funksionet e orës (Kohëzgjatja , Koha përfund.).
 - Kur pajisja është e fikur, ju mund ta përdorni këtë nxehtësi për të mbajtur ushqimin e ngrohtë. Në ekran shfaqet temperatura e mbetur.
- **Çaktivizimi i ekranit** - Nëse është e nevojshme, mund ta çaktivizoni plotësisht pajisjen. Prekni  dhe  njëkohësisht, derisa ekrani të fiket. Ky hap aktivizon edhe pajisjen.
- **Gatimi me llambën e fikur** - Prekni dhe mbani prekur  për 3 sekonda për të çaktivizuar llambën gjatë gatimit.
- **Funksionet EKO** - referojuni " Funksionet e nxehtjes ".

6. FUNKSIONET E ORËS

6.1 Funksionet e orës

Simboli	Funksioni	Përshkrimi
	Kujtuesi i minutave	Për të vendosur një numërim mbrapsht (maksimumi 2 orë e 30 minuta). Ky funksion nuk ndikon në funksionimin e pajisjes. Ju mund ta aktivizoni edhe kur pajisja është e çaktivizuar. Përdorni  për të aktivizuar funksionin. Shtypni  ose  për të vendosur minutat dhe OK për të filluar.
	Kohëzgjatja	Për vendosjen e kohëzgjatjes pajisja duhet të jetë në funksionim (max. 23 orë e 59 min).
	Koha përfund.	Për të cilësuar kur do të fiket një funksion i nxehtjes (max. 23 orë e 59 min).

Nëse ju vendosni kohën për një funksion të orës, koha fillon të numëroj mbrapsht pas 5 sekondash.



Nëse përdorni funksionet e orës Kohëzgjatja $\left| \rightarrow \right|$ dhe Koha përfund. $\rightarrow \left| \right|$, pajisja çaktivizon elementët ngrohës pasi ka përfunduar 90 % e kohës së vendosur. Pajisja përdor nxehtësinë e mbetur për të vazhduar procedurën së gatimit, derisa koha të ketë përfunduar koha (3 - 20 minuta).

Cilësimi i funksioneve të orës

1. Cilësoni një funksion nxeheje.
2. Shtypni \mathcal{O} vazhdimisht derisa sa ekrani të tregoj funksionin e duhur të orës dhe simbolin përkatës.
3. Shtypni \wedge ose \vee për të vendosur kohën e nevojshme. Shtypni **OK** për të konfirmuar.
Kur koha përfundon, tingëllon një sinjal akustik. Pajisja çaktivizohet. Në ekran shfaqet një mesazh.
4. Shtypni një fushë sensori për të ndaluar sinjalin.



- Me funksionet Kohëzgjatja $\left| \rightarrow \right|$ dhe Koha përfund. $\rightarrow \left| \right|$ duhet të cilësoni në fillim funksionin e nxehtësisë dhe temperaturën. Më pas mund të vendosni funksionin e orës. Pajisja çaktivizohet automatikisht.
- Ju mund të përdorni funksionin Kohëzgjatja $\left| \rightarrow \right|$ dhe Koha përfund. $\rightarrow \left| \right|$ në të njëjtën mënyrë, nëse dëshironi ta aktivizoni e çaktivizoni automatikisht pajisjen më vonë.
- Kur përdorni sensorin e temperaturës (nëse ka), funksionet Kohëzgjatja $\left| \rightarrow \right|$ dhe Koha përfund. $\rightarrow \left| \right|$ nuk funksionojnë.

6.2 Nxehtësi + Mbaj

Funksioni Nxehtësi + Mbaj e mban ushqimin e përgatitur ngrohtë në 80 °C për 30

minuta. Aktivizohet pasi procedura e pjekjes dhe gatimit përfundon.



- Ju mund ta aktivizoni ose çaktivizoni funksionin në mënyrë Cilësimet bazë .
- Kushtet për funksionimin:
 - Temperatura e vendosur është më shumë se 80 °C.
 - Funksioni Kohëzgjatja është cilësuar.

Aktivizimi i funksionit

1. Aktivizoni pajisjen.
2. Përzgjidhni funksionin e nxehtësisë.
3. Vendosni temperaturën mbi 80 °C.
4. Shtypni \mathcal{O} vazhdimisht derisa ekrani të tregojë Nxehtësi + Mbaj . Shtypni **OK** për të konfirmuar.

Kur funksioni përfundon, tingëllon një sinjal akustik.

Funksioni Nxehtësi + Mbaj funksionon për 30 minuta.

Funksioni Nxehtësi + Mbaj qëndron ndezur nëse ju ndryshoni funksionet e nxehtësisë.

6.3 Kohë shtesë

Funksioni Kohë shtesë bën që funksioni i nxehtësisë të vazhdojë pasi të ketë përfunduar Kohëzgjatja .

- E aplikueshme për të gjitha funksionet e nxehtësisë me Kohëzgjatja ose Peshë automatike.
- Nuk përdoret me të gjitha funksionet e furrës me Sensori i temperaturës .

Aktivizimi i funksionit:

1. Kur koha e gatimit përfundon, tingëllon një sinjal akustik. Shtypni një fushë sensori.
2. Në ekran shfaqet mesazhi për Kohë shtesë për pesë minuta.
3. Shtypni \mathcal{O} për të aktivizuar (ose \leftarrow për të anuluar).
4. Vendosja e kohëzgjatjes së Kohë shtesë . Shtypni **OK** për të konfirmuar.

7. PROGRAMET AUTOMATIKE

7.1 Gatim i asistuar me Recetë automatike

Kjo pajisje ka një numër recetash që mund të përdorni. Recetat janë të caktuara e ju nuk mund t'i ndryshoni ato.

Aktivizimi i funksionit:

1. Aktivizoni pajisjen.
2. Zgjidhni menynë Gatim i asistuar . Shtypni **OK** për të konfirmuar.
3. Zgjidhni kategorinë dhe gatesën. Shtypni **OK** për të konfirmuar.
4. Zgjidhni menynë Recetë automatike . Shtypni **OK** për të konfirmuar.



Kur përdorni funksionin Manuale , pajisja përdor cilësimet automatike. Ju mund t'i ndryshoni ato sikurse me funksionet e tjera.

7.2 Gatim i asistuar me Peshë automatike

Ky funksion llogarit automatikisht kohën e pjekjes. Për të përdorur funksionin, është

e nevojshme të cilësoni peshën e ushqimit.

Aktivizimi i funksionit:

1. Aktivizoni pajisjen.
2. Zgjidhni Gatim i asistuar . Shtypni **OK** për të konfirmuar.
3. Zgjidhni kategorinë dhe gatesën. Shtypni **OK** për të konfirmuar.
4. Zgjidhni Peshë automatike . Shtypni **OK** për të konfirmuar.
5. Prekni \wedge ose \vee për të vendosur peshën e ushqimit. Shtypni **OK** për të konfirmuar.

Programi automatik fillon. Peshën mund ta ndryshoni në çdo kohë. Shtypni \wedge ose \vee për të ndryshuar peshën. Kur koha përfundon, tingëllon një sinjal akustik. Shtypni një fushë sensor për të çaktivizuar sinjalin.



Me disa programe kthejeni ushqimin në anë të kundërt mbas 30 minutash. Në ekran shfaqet një mesazh kujtese.


8. PËRDORIMI I AKSESORËVE




PARALAJMËRIM

Referojuni kapitullit "Të dhëna për sigurinë"

8.1 Shinat teleskopike



1. Tërhiqni jashtë shinat teleskopike të krahut të djathtë dhe të majtë.



2. Vendoseni raftin me rretë mbi shinat teleskopike e më pas shtyjeni ato me kujdes brenda pajisjes.

Sigurohuni që shinat teleskopike t'i fusni brenda plotësisht në pajisje përpara se të mbyllni derën e furrës.




Ruajini udhëzimet për shinat teleskopike për përdorim në të ardhmen.




KUJDES

Mos i pastroni shinat teleskopike në enëlarëse. Mos i lubrifikoni shinat teleskopike.

8.2 Aksesorë për pjekjen me avull




Tavë dietike për funksionet e gatimit me avull. Tava ka dy pjesë: një vrimë për injektorin (B) dhe një skarë çeliku për të vendosur në fund të tavës.



Injektori dhe tubi prej gome. "A" është tubi prej gome, "B" është injektori për gatimin me avull dhe "C" është injektori për gatim direkt me avull.


Gatimi me avull me tavë dietike



Vendosini ushqimet në skarën prej çeliku brenda tavës. Shtoni pak ujë. Fusni injektorin (B) brenda tubit prej gome. Fusni injektorin (B) brenda zgavrës së veçantë në tavën dietike. Futeni konektorin e lidhur me tubit prej gome (A) në valvulën e hyrjes së avullit.

Vendoseni tavën në nivelin e parë ose të dytë duke filluar nga poshtë. Sigurohuni që të mos shtypni tubin prej gome ose të mos e lini të prek një element të nxehtë në pjesën e sipërme të furrës. Vendosni furrën për funksionin e gatimit me avull.

Gatimi i drejtpërdrejtë me avull




Vendosini ushqimet në skarën prej çeliku brenda tavës. Shtoni pak ujë. Fusni injektorin (C) brenda tubit prej gome. Futeni konektorin e lidhur me tubit prej gome (A) në valvulën e hyrjes së avullit.



Mos përdorni pjesën e sipërme të tavës.

Kur gatua ushqime si mish pule, rose, gjel deti, keç ose peshk të madh, fusni injektorin (C) drejtpërdrejt në pjesën e zbratur të mishit. Sigurohuni që të mos bllokoni vrimat.



Vendoseni tavën në nivelin e parë ose të dytë duke filluar nga poshtë. Sigurohuni që të mos shtypni tubin prej gome ose të mos e lini të prek një element të nxehtë në pjesën e sipërme të furrës. Vendosni furrën për funksionin e gatimit me avull. Për më shumë informacion mbi gatimin e kombinuar me avull referojuni tabelave të gatimit për gatim me avull.








Tubi i gomës është e projektuar posaçërisht për gatim dhe nuk përmban substanca të rrezikshme.

9. FUNKSIONET SHITESË

9.1 Menyja Programi i preferuar



Ju mund t'i ruani cilësimet e preferuara të tilla si kohëzgjatja, temperatura ose funksioni i nxehtë. Ato gjendet në menynë Programi i preferuar . Ju mund të ruani deri në 20 programe.

Ruajtja e një programi

1. Aktivizoni pajisjen.
2. Zgjidhni një funksion nxehtë ose një Gatim i asistuar .
3. Prekni  vazhdimisht derisa ekrani të tregoj **RUAJ** . Shtypni **OK** për të konfirmuar.
4. Në ekran shfaqet pozicioni i parë bosh i memories.
Shtypni **OK** për të konfirmuar.
5. Vendosni emrin e programit. Germa e parë pulson.
Prekni  ose  për të ndryshuar germen. Shtypni **OK**.
6. Prekni  ose  për të lëvizur kursorin djathtas ose majtas. Shtypni **OK**.
Germa tjetër pulson. Bëni hapat 5 dhe 6 përsëri sipas nevojës.
7. Shtypni dhe mbani **OK** për të ruajtur.




Informacion i nevojshëm:

- Ju mund ta mbivendosni një pozicion memorieje. Kur ekrani tregon pozicionin e parë bosh të memories, prekni  ose  dhe shtypni **OK** për të mbishkruar një program ekzistues.
- Ju mund ta ndryshoni emrin e programit në menynë Edito emrin e programit .

Aktivizimi i programit


1. Aktivizoni pajisjen.
2. Përzgjidhni menynë Programi i preferuar . Shtypni **OK** për të konfirmuar.
3. Zgjidhni emrin e programit të preferuar. Shtypni **OK** për të konfirmuar.

Shtypni  për të shkuar direkt te Programi i preferuar .

9.2 Bllokimi i butonave

Bllokimi i butonave Bllokimi i butonave parandalon ndryshimin aksidental të funksionit të nxehtë. Mund ta aktivizoni vetëm kur pajisja është në punë.



Aktivizimi i Bllokimi i butonave :

1. Aktivizoni pajisjen.
2. Cilësoni një funksion nxehtëje.
3. Shtypni  disa herë derisa në ekran të shfaqet Bllokimi i butonave.
4. Shtypni **OK** për të konfirmuar.
5. Dera mbyllet dhe simboli përkatës e shiriti tregues ndizen në ekran.



Nëse pajisja ka funksion të pastrimit pirolitik dhe funksioni është në punë, dera është e bllokuar.



Çaktivizimi i Bllokimi i butonave :

1. Shtypni  . Në ekran shfaqet një mesazh.
2. Shtypni  dhe më pas **OK** për ta konfirmuar.

9.3 Bllokimi për fëmijët



Funksioni i bllokimit për fëmijët parandalon funksionimin aksidental të pajisjes.

Aktivizimi dhe çaktivizimi i funksionit të bllokimit për fëmijët:

1. Aktivizoni pajisjen.
2. Prekni  dhe  njëkohësisht, derisa në ekran të shfaqet një mesazh.



Nëse pajisja ka funksion të pastrimit pirolitik dhe funksioni është në punë, dera është e bllokuar.
Në ekran shfaqet një mesazh kur prekni një fushë me sensor.




Për të zhblokuar pajisjen, prekni  dhe  njëkohësisht sërish, derisa në ekran të shfaqet një mesazh.

9.4 CILËSO + NIS

Funksioni CILËSO + NIS ju lejon të vendosni një funksion (ose program)

nxeheje dhe ta përdorni më vonë me një shtypje të fushës së sensorit.

Aktivizimi i funksionit:

1. Aktivizoni pajisjen.
2. Cilësoni funksionin e nxehtësisë.
3. Shtypni  vazhdimisht derisa ekrani të tregojë Kohëzgjatja .
4. Vendos kohën.
5. Shtypni  vazhdimisht derisa ekrani të tregojë CILËSO + NIS .
6. Shtypni **OK** për të konfirmuar. Për të nisur CILËSO + NIS , shtypni një fushë sensori (përveç ). Funksioni i cilësuar i nxehtësisë aktivizohet. Kur funksioni i nxehtësisë përfundon, tingëllon një sinjal akustik.



Informacion i nevojshëm:

- Kur funksioni i nxehtësisë është në punë, funksioni Bllokimi i butonave është i ndezur.
- Ju mund ta aktivizoni ose çaktivizoni funksionin CILËSO + NIS në menyën Cilësimet bazë .

9.5 Fikja automatike

Për arsye sigurie pajisja çaktivizohet vetë pas një farë kohe:

- Nëse funksioni i furrës është në punë.
- Nëse nuk e ndryshoni temperaturën e furrës.

Temperatura e furrës	Ora e fikjes
30 °C - 120 °C	12,5 orë
120 °C - 200 °C	8,5 orë
200 °C - 250 °C	5,5 orë
250 °C - maksimum °C	3,0 orë



Fikja automatike funksionon me të gjitha funksionet, përveç Të lehta , Kohëzgjatja dhe Koha përfund.

9.6 Ventilatori ftohës

Kur pajisja është në punë, ventilatori ftohës aktivizohet automatikisht për t'i mbajtur sipërfaqet e pajisjes të ftohta. Nëse çaktivizoni pajisjen, ventilatori i ftohjes mund të vazhdojë të punojë derisa të ftohet temperatura në pajisje.

9.7 Termostati i sigurisë

Përdorimi i pasaktë i pajisjes ose pjesët me defekt mund të shkaktojnë mbinxehtë të rrezikshme. Për ta parandaluar këtë, furra ka një termostat sigurie që ndërpret furnizimin me energji. Furra ndizet aktivizohet përsëri automatikisht kur bie temperatura.

10. UDHËZIME DHE KËSHILLA TË NEVOJSHME

- Pajisja ka pesë nivele raftesh. Numërojeni nivelet e pajisjes duke filluar nga poshtë.
- Pajisja ka një sistem të veçantë që qarkullon ajrin dhe riciklon vazhdimisht avullin. Me këtë sistem bëhet i mundur gatimi në një ambient me avull dhe i mban gatesat të buta brenda dhe të pjekura mirë nga jashtë. Ai ul kohën e gatimit dhe konsumin e energjisë në minimum.
- Në pajisje ose në panelet e dyerve prej xhami mund të kondensohet lagështi. Kjo është normale. Qëndroni gjithmonë pak larg pajisjes kur hapni derën e pajisjes ndërsa është në punë. Për të ulur kondensimin, përdoreni pajisjen bosh për 10 minuta para gatimit.
- Fshini lagështinë e formuar pas çdo përdorimi të pajisjes.
- Mos vendosni objekte drejtpërdrejt mbi bazën e pajisjes dhe mos i mbulonit pjesët e pajisjes me letër alumini gjatë gatimit. Kjo mund të ndryshojë rezultatet e pjekjes dhe mund të shkaktojë dëmtimin e smaltit të furrës.

10.1 Pjekja e kekëve

- Mos e hapni derën e furrës para se të ketë kaluar 3/4 e kohës së pjekjes.
- Nëse përdorni dy tava pjekjeje njëkohësisht, mbajeni një nivel bosh mes tyre.

10.2 Gatimi i mishit dhe peshkut

- Përdorni një tavë të thellë për ushqimet me shumë yndyrë, për të ruajtur furrën nga njollat që mund të mos ikin më.
- Lëreni mishin afro 15 minuta përpara se ta shponi, në mënyrë që lëngu të mos derdhet jashtë.

10.4 Tabela e pjekjes dhe e skuqjes

KEKË

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Ventilator i plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Recetat me qull të rrahur	2	170	3 (2 dhe 4)	160	45 - 60	Në një formë keku
Brumë i shkrifët për ëmbëlsirë	2	170	3 (2 dhe 4)	160	20 - 30	Në një formë keku
Kek me gjalpë qumështi e krem bulmeti	1	170	2	165	80 - 100	Në një formë keku 26 cm
Kek me mollë (Ëmbëlsirë me mollë)	2	170	2 (majtas dhe djathtas)	160	80 - 100	Në dy forma keku prej 20 cm në një raft me rrjetë ¹⁾
Strudel	3	175	2	150	60 - 80	Në një tavë pjekjeje
Ëmbëlsirë me reçel	2	170	2 (majtas dhe djathtas)	165	30 - 40	Në një formë keku 26 cm
Pandispanjë	2	170	2	150	40 - 50	Në një formë keku 26 cm
Kek krishtlindjesh /Kek i pasur me fruta	2	160	2	150	90 - 120	Në një formë keku 20 cm ¹⁾

- Për të parandaluar tymin e tepërt në furrë gjatë pjekjes, hidhni pak ujë në tavën e thellë. Për të parandaluar kondensimin e tymit, shtoni ujë sa herë që të thahet.

10.3 Kohët e gatimit

Kohët e gatimit varen nga lloji, shpeshësia dhe vëllimi i ushqimit. Fillimisht, kontrolloni funksionimin e pajisjes kur gatvani. Gjeni përzgjedhjet më të mira (përzgjedhjet e nxehtësisë, kohët e gatimit, etj.) për gatesat tuaja, recetat dhe sasitë përkatëse kur përdorni pajisjen.

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Ventilator i plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicion i i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Kek me kumbulla	1	175	2	160	50 - 60	Në një tavë buke ¹⁾
Kekë të vegjël - në një nivel	3	170	3	150 - 160	20 - 30	Në një tavë pjekjeje ¹⁾
Kekë të vegjël - në dy nivele	-	-	2 dhe 4	140 - 150	25 - 35	Në një tavë pjekjeje ¹⁾
Kekë të vegjël - në tre nivele	-	-	1, 3 dhe 5	140 - 150	30 - 45	Në një tavë pjekjeje ¹⁾
Biskota / rripa brumi të shkrifët - në një nivel	3	140	3	140 - 150	25 - 45	Në një tavë pjekjeje
Biskota / rripa brumi të shkrifët - në dy nivele	-	-	2 dhe 4	140 - 150	35 - 40	Në një tavë pjekjeje
Biskota / rripa brumi të shkrifët - në tre nivele	-	-	1, 3 dhe 5	140 - 150	35 - 45	Në një tavë pjekjeje
Mafishe - në një nivel	3	120	3	120	80 - 100	Në një tavë pjekjeje
Mafishe - në dy nivele	-	-	2 dhe 4	120	80 - 100	Në një tavë pjekjeje ¹⁾
Simite	3	190	3	190	12 - 20	Në një tavë pjekjeje ¹⁾
Ekler - në një nivel	3	190	3	170	25 - 35	Në një tavë pjekjeje
Ekler - në dy nivele	-	-	2 dhe 4	170	35 - 45	Në një tavë pjekjeje
Torta të sheshta	2	180	2	170	45 - 70	Në një formë keku 20 cm
Kek i pasur me fruta	1	160	2	150	110 - 120	Në një formë keku 24 cm
Kek "Viktoria"	1	170	2 (majtas dhe djathtas)	160	30 - 50	Në një formë keku 20 cm ¹⁾

¹⁾ Ngrohni paraprakisht për 10 minuta.

BUKË DHE PICA

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Ventilator i plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Bukë e bardhë	1	190	1	190	60 - 70	1 - 2 copë, 500 g për copë ¹⁾
Bukë thekre	1	190	1	180	30 - 45	Në një tavë buke
Simite	2	190	2 (2 dhe 4)	180	25 - 40	6 - 8 simite në një tavë pjekjeje ¹⁾
Pica	1	230 - 250	1	230 - 250	10 - 20	Në një tavë pjekjeje ose tavë të thellë ¹⁾
Gurabije	3	200	3	190	10 - 20	Në një tavë pjekjeje ¹⁾

¹⁾ Ngrohni paraprakisht për 10 minuta.

KREM I PJEKUR

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Ventilator i plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Bazë brumi	2	200	2	180	40 - 50	Në një formë
Pite me perime	2	200	2	175	45 - 60	Në një formë
Quiche	1	180	1	180	50 - 60	Në një formë ¹⁾
Lazanja	2	180 - 190	2	180 - 190	25 - 40	Në një formë ¹⁾
Kaneloni	2	180 - 190	2	180 - 190	25 - 40	Në një formë ¹⁾

¹⁾ Ngrohni paraprakisht për 10 minuta.

MISH

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Ventilator i plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Mish lope	2	200	2	190	50 - 70	Në një raft me rretë

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Ventilator i plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Mish derri	2	180	2	180	90 - 120	Në një raft me rrjetë
Viç	2	190	2	175	90 - 120	Në një raft me rrjetë
Rosto viçi angleze, e pjekur pak	2	210	2	200	50 - 60	Në një raft me rrjetë
Rosto viçi angleze, e pjekur mesatarisht	2	210	2	200	60 - 70	Në një raft me rrjetë
Rosto viçi angleze, e pjekur mirë	2	210	2	200	70 - 75	Në një raft me rrjetë
Shpatull derri	2	180	2	170	120 - 150	Me lëkurë
Kërci derri	2	180	2	160	100 - 120	2 copë
Mish qengji	2	190	2	175	110 - 130	Kofshë
Pulë	2	220	2	200	70 - 85	I paprerë
Gjel deti	2	180	2	160	210 - 240	I paprerë
Rosë	2	175	2	220	120 - 150	I paprerë
Patë	2	175	1	160	150 - 200	I paprerë
Lepur	2	190	2	175	60 - 80	I prerë në copa
Lepur i egër	2	190	2	175	150 - 200	I prerë në copa
Fazan	2	190	2	175	90 - 120	I paprerë

PESHK

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Ventilator i plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Troftë / Krap deti	2	190	2	175	40 - 55	3 - 4 peshq

LLOJI I GATIMIT	Gatim tradicional		Ventilator i plotë		Koha e gatimit [në minuta]	Shënime
	Pozicio ni i raftit	Temp [°C]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]		
Peshk ton / Salmon	2	190	2	175	35 - 60	4 - 6 fileto

10.5 Pjekja në skarë



Nxehni paraprakisht furrën bosh për 10 minuta, para gatimit.

LLOJI I GATIMIT	Sasia		Pjekja në skarë		Koha e gatimit [në minuta]	
	Copë	[g]	Pozicioni i raftit	Temp [°C]	Njëra anë	Ana tjetër
Biftek fileto	4	800	4	maks.	12-15	12-14
Biftek	4	600	4	maks.	10-12	6-8
Salsiçe	8	-	4	maks.	12-15	10-12
Kotëleta derri	4	600	4	maks.	12-16	12-14
Pulë (e ndarë në 2 pjesë)	2	1000	4	maks.	30-35	25-30
Qebapë	4	-	4	maks.	10-15	10-12
Gjoks pule	4	400	4	maks.	12-15	12-14
Hamburger	6	600	4	maks.	20-30	-
Filetë peshku	4	400	4	maks.	12-14	10-12
Sanduiçë të thekur	4-6	-	4	maks.	5-7	-
Bukë e thekur	4-6	-	4	maks.	2-4	2-3

10.6 Skarë turbo

Mish lope

LLOJI I GATIMIT	Sasia	Pozicioni i raftit	Temperatur a [°C]	Koha [minuta]
Bërxolla gjedhi ose fileto, e gatuar pak	për cm trashësi	1	190 - 200 ¹⁾	5 - 6
Bërxollë gjedhi ose fileto, e gatuar mesatarisht	për cm trashësi	1	180 - 190 ¹⁾	6 - 8
Bërxollë gjedhi ose fileto, e gatuar mirë	për cm trashësi	1	170 - 180 ¹⁾	8 - 10

1) Nxehni furrën paraprakisht.

Mish derri

LLOJI I GATIMIT	Sasia	Pozicioni i raftit	Temperatur a [°C]	Koha [minuta]
Shpatull, qafë, kofshë	1 - 1,5 kg	1	160 - 180	90 - 120
